



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenin 51, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", dhe konform nenit 29 dhe 39, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 3 lidhur me nenin 6 pika 4 dhe nenin 8, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 14.01.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

Për themelimin e komiteteve të përhershëm

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës në Suharekë, themelon komitetet e përhershëm dhe përcakton numrin e anëtarëve (ulëseve) si më poshtë:

1. Komitetin për Politik dhe Financa

1.1 Komiteti i lartcekur do të ketë 7, (shtatë) ulëse-anëtarë dhe

2. Komitetin për Komunitete

2.1 Komiteti i lartcekur do të ketë 7, (shtatë) ulëse-anëtarë

Neni 2

2.1 Përbërja e Komitetit për politik dhe financa, duhet të reflektoj përfaqësimin e entiteteve politike si dhe numrin e ulëseve nga entitetet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës.

2.2 Përbërja e Komitetit për Komitetet duhet të jetë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë jashtë tije.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komiteteve të përhershme, janë të përcaktuara me Ligjin Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), dhe Statutin e Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008 dhe aktet tjera Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr- 016-2803
Me date 14.01.2026



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Mërc Boxhet KUÇI